



**Ligji 39/2018 Date 09.07.2018**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 8438, DATË 28.12.1998,  
“PËR TATIMIN MBI TË ARDHURAT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 155, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në nenin 8/1, pika 11, paragrafi i parë ndryshohet si më poshtë:

“11. Të ardhurat e realizuara nga kalimi i së drejtës së pronësisë mbi tokën bujqësore nga një fermer i regjistruar te një fermer tjetër apo një person fizik a juridik që kryen aktivitet bujqësor. Përfshihen, gjithashtu, rastet e kalimit të së drejtës së pronësisë brenda lidhjes gjinore burrë, grua, fëmijë, nëpërmjet dhurimit dhe/ose heqjes dorë nga pasuria, kur pasuria rrjedh nga bashkëpronësia e detyrueshme e fituar në bazë të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991, “Për tokën”, të ndryshuar.”.

Neni 2

Në nenin 11, pika 1, ndryshohet si më poshtë:

“1. Fitimi kapital i realizuar si rezultat i kalimit të së drejtës së pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme, ndërtesë, truall dhe tokë bujqësore, tatohet me normën 15 për qind.

Shkëmbimi i truallit me sipërfaqe ndërtimi, në bazë të një kontrate shkëmbimi, nuk përbën moment për llogaritje të ndonjë fitimi kapital nga transferimi i pasurisë së paluajtshme.”.

Neni 3

Në nenin 20, paragrafët e tretë dhe të katërt shfuqizohen.

Neni 4

Në nenin 28 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Shkalla e tatimit mbi fitimin është:

- 5 % për tatimpaguesit me të ardhura deri në 14 000 000 lekë në vit.
- 15 % për tatimpaguesit me të ardhura mbi 14 000 000 lekë në vit.”.

2. Pas pikës 2 shtohen pikat 3 dhe 4 me këtë përmbajtje:  
“3.Për personat juridikë, të cilët zhvillojnë veprimtari ekonomike sipas ligjit nr. 38/2012, “Për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor”, shkalla e tatimit mbi fitimin është 5 %.

4.Për subjektet, të cilat zhvillojnë veprimtari pritëse të certifikuar si “agroturizëm”, sipas legjislacionit në fuqi në fushën e turizmit, shkalla e tatimit mbi fitimin është 5 %. Kjo shkallë aplikohet për një periudhë 10-vjeçare për personat juridikë që përfitojnë statusin “subjekt i certifikuar agroturizmi”, deri më 31 dhjetor 2021. Aplikimi i shkallës së reduktuar fillon në vitin tatimor pasardhës, pas përfitimit të statusit “subjekt i certifikuar agroturizmi.”.

#### Neni 5

Në nenin 33/1 bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Në pikën 2 hiqen fjalët “dhe personat fizikë”,“/vendimin e personit fizik”, si dhe “për çdo muaj vonesë”.

2. Në pikën 4 hiqen fjalët “/vendimi i personit fizik”.

#### Neni 6

Në nenin 38, pika 7, paragrafi idytë ndryshohet si më poshtë:

“Tatimi mbi lojërat e fatit, sipas nenit 52/2, të ligjit 155/2015, “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, aplikohet me shkallën 15 % mbi të ardhurat bruto nga loja për të gjitha kategoritë e lojërave të fatit, përfshirë Lotarinë Kombëtare të licencuar sipas ligjit nr. 95/2013. E ardhura bruto nga loja është shuma e mbetur organizatorit nga diferenca midis shumës totale të luajtur nga lojtarët në lojërat e fatit dhe shumës së fituar prej tyre.

Tatimi mbi fitimin llogaritet në përputhje me dispozitat e këtij ligji.”.

#### Neni 7

#### **Dispozitë kalimtare**

Neni 2, që ndryshon nenin 20, “Shpenzime të njohura”, të ligjit, nuk do të zbatohet për kontratat e shkëmbimit që janë regjistruar në ZRPP para datës së hyrjes në fuqi të këtij ligji.

#### Neni 8

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare, me përjashtim të nenit 3, i cili hyn në fuqi më 1 janar 2019.

KRYETARI  
**Gramoz Ruçi**

Miraturar në datën 9.7.2018

Botuar ne F.Zyrtare 134/2018

Dale nga shtypi me 18.09.2018